

VENDIM
Nr. 668, datë 12.11.2025

**PËR FORMËN, MËNYRËN DHE PROCEDURËN E RAPORTIMIT TË TË
DHËNAVE NGA AUTORITETET LICENCUESE DHE MBIKËQYRËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse raportojnë tek autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, menjëherë dhe jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë nga çasti i konstatimit të çdo dyshimi, informacioni apo të dhëne, që lidhet me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, apo financimin e armëve të shkatërrimit në masë, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre, në rastet kur:

a) kanë dyshime që mund të lidhen me parregullsi në dokumentacionin identifikues e justifikues të burimit të ligjshëm të kapitaleve me ato reale;

b) vërejnë mosjustifikim të pasurisë apo të parave të deklaruara nga pikëpamja ekonomike ose ligjore;

c) kanë informacione, sinjalizime se të dhënat për paratë apo pasuritë e depozituara për licencim rrjedhin nga vepra penale ose janë të përziera me para apo pasuri të tilla, apo kur dyshojnë se veprimtaria që kërkohet të licencohet do të ngrihet për të realizuar ose për të mbështetur pastrimin e parave;

ç) kanë të dhëna apo dyshime për përfshirje ose qëllime, që vërtetojnë se veprimtaria do të përdoret për të kryer, mbështetur, lehtësuar, ruajtur, nxitur ose fshehur aktet terroriste apo do të financojnë terrorizmin;

d) kanë dyshime të tjera, të bazuara në gjendjen ose në rrethanat, që nuk janë parashikuar më lart.

2. Mënyra e raportimit nga autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse në Agjencinë e Inteligjencës Financiare bëhet në formë shkresore ose elektronike me anë të formularit që paraqitet në aneksin I “Formulari i raportimit të aktivitetit të dyshimtë nga autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse”, shoqëruar nga instruksionet për plotësimin e tij, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Raportimi në formë elektronike kryhet në platformën elektronike të administruar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.

3. Informacioni i raportuar apo i shkëmbyer me Agjencinë e Inteligjencës Financiare kryhet në bazë të konfidencialitetit të ndërsjellë.

4. Autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse i kthejnë përgjigje Agjencisë së Inteligjencës Financiare brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për informacion. Në raste urgjente, autoriteti përgjegjës mund të kërkojë informacion edhe brenda një afati më të shkurtër sesa ai i parashikuar në ligj.

5. Vendimi nr. 343, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe autoritetet licencuese e mbikëqyrëse, të përcaktuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

ANEKSI I
FORMULARI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË
NGA AUTORITETET LICENCUESE DHE MBIKËQYRËSE

PJESA I
PERSONI FIZIK DHE JURIDIK I LICENCUAR DHE I MBIKËQYRUR

1. a) Emri _____ b) Atësia ¹ _____ c) Mbiemri _____			
ç) Emërtimi i shoqërisë _____			
2 Statusi: a) Individ ☐ b) Person fizik ☐ c) Person juridik ☐ d) Përfaqësues ligjor ☐			
3. Punësimi/Institucioni: _____		4. Profesioni: _____	
5. Dokumenti i identifikimit _____			
Numri: _____			
Datëlindja _____ Vendlindja _____			
Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT): _____			
Adresa _____			

PJESA II
INFORMACION PËR TRANSAKSIONIN/ET DHE AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1. Numri dhe data e licencës: _____
2. Lloji i transaksionit: _____
3. Qëllimi i transaksionit: _____
4. Shuma e përfshirë në transaksion: _____
5. Zgjidhni monedhën: LEK _____ EUR _____ USD _____ Tjetër _____
6. Data e transaksionit: _____
7. Burimi i deklaruar i fondeve: _____
8. Mënyra e pagesës: _____
9. Arsyeja e dyshimit: _____

PJESA III
INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

1. Organi licencues/mbikëqyrës _____	2. Personi përgjegjës: _____
3. Numër telefoni: _____	4. Adresë e-mail-i: _____
5. Adresa: _____	_____

INSTRUKSIONE PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË
RAPORTIMIT TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË NGA AUTORITETET LICENCUESE
DHE MBIKËQYRËSE

Këto instruksione jepen për të ndihmuar autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse për plotësimin e formularit të raportimit të aktivitetit të dyshimtë.

Ky formular do të raportohet pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

¹ Kur deklarohet.

PJESA I: PERSONI FIZIK E JURIDIK I LICENCUAR DHE I MBIKËQYRUR

Në këtë pjesë përshkruhen të dhënat rreth subjektit, si më poshtë:

- Kur subjekti është individ, shënoni një kryq te kuadrati “individ”, pika 2, shkronja “a”, dhe plotësoni të gjitha rubrikat: emër, atësi, mbiemër, punësimi/institucioni, profesioni, dokumenti i identifikimit dhe numri, datëlindja, vendlindja dhe adresa;
- Kur subjekti është person fizik, person juridik apo shoqëri, shënoni një kryq te kuadrati përkatës për personin fizik tregtar dhe personin juridik, pika 2 “Statusi”, shkronjat “b” dhe “c”, dhe të plotësohen rubrikat: emërtimi i shoqërisë, NIPT-i, adresa;
- Kur subjekti është përfaqësues ligjor shënoni një kryq te kuadrati përkatës për “përfaqësuesin ligjor”, pika 2 “Statusi”, shkronja “d”, dhe të plotësohen të gjitha rubrikat që përmban pjesa I.

PJESA II: INFORMACION PËR TRANSAKSIONIN/ET DHE AKTIVITETIN E DYSHIMTË

Në këtë rubrikë do të plotësohen të dhëna për transaksionin apo transaksionet dhe duhet të plotësohen të gjitha rubrikat përkatëse të kësaj pjese:

- pika 1, shënoni numrin dhe datën e licencës së subjektit për të cilin po raportoni;
- pika 2, përshkruani llojin e transaksionit;
- pika 3, përshkruani qëllimin e kryerjes së transaksionit;
- pika 4, përshkruani shumën apo shumat e përfshira në transaksion;
- pika 5, shënoni kryq në monedhën përkatëse të vlerës së përfshirë në transaksion;
- pika 6, shënoni datën e kryerjes së transaksionit;
- pika 7, përshkruani se çfarë ka deklaruar subjekti si burim të fondeve; është rubrikë shumë e rëndësishme, që nuk duhet të lihet asnjëherë e paplotësuar;
- pika 8, përshkruani mënyrën se si është bërë pagesa apo pagesat, p.sh.: me bankë, para fizike *cash* apo tjetër;
- pika 9, përshkruani në mënyrë të hollësishme çdo detaj dhe arsyen apo arsyet e dyshimit, si dhe dërgoni bashkëlidhur çdo dokument, ku mbështetni dyshimin tuaj.

Në rastet kur kemi transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, do të shënoni shumën totale të pika 4 e pjesës II, **Shuma e përfshirë në transaksion** dhe të pika 9, **“Arsyet e dyshimit”**, do të përshkruani të gjitha transaksionet.

PJESA III: INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë plotësohen të dhëna rreth autoritetit licencues e mbikëqyrës:

- pika 1, shënoni emërtimin e autoritetit tuaj licencues dhe mbikëqyrës, që bën raportimin;
- pika 2, shënoni emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës, që po bën raportimin;
- pika 3, shënoni numrin zyrtar të telefonit të autoritetit tuaj licencues e mbikëqyrës;
- pika 4, adresa zyrtare *e-mail*-it e autoritetit licencues dhe mbikëqyrës;
- pika 5, adresa e zyrtare e autoritetit licencues e mbikëqyrës.